



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**

---

### **EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së gjashtë të Kuvendit, mbajtur më 16.07.2021, e cila filloi në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Drilon Pireva (PSD), Bashkim Beha (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Nol Nushi (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Egzon Azemi (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Naim Hoxha (LVV), Nazlie Bala (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Vjollca Rizani (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Elmiro Nikçi - Rexha (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Suzan Kika, (PDK), Florida Canolli (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Fiknete Bejta (Grupi i pavarur), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR), Adelina Fazliji (AKR), Arbenita Murseli (AKR), Sami Boroci (AKR), Granit Shala (Nisma), Rifat Deri (i pavarur) dhe Sokol Berisha (Grupi i pavarur).

**Munguan:** Migjen Shala (PDK), Visare Gashi (PSD), Shefqet Osmani (LDK), Naime Osmani (LDK), Berat Lahu (LVV), Kreshnik Smajlaj (Grupi i pavarur), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK) dhe Valbona Petrovci (e pavarur).

**Të pranishëm ishin edhe:** Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës, Muhedin Nushi, nënkryetar i Komunës, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Valbona Ajeti, drejtoreshë e Drejtorisë së Kadastrit, Adrian Berisha, drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Dren Kukaj, drejtor i Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhivillimit të Qëndrueshëm, Vasilika Zotaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, Medina Braha, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, përfaqësuesit e Policisë së Kosovës, Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve dhe përfaqësues të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues i Kuvendit.

**Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.**

**Osman Bllaca** propozoi që në rend të ditës të futet edhe pika "Propozimvendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Prishtina e Re", Zona perëndim".

**Rifat Deri**, propozoi që në rend të ditës të futet edhe pika: Propozimvendimi për formimin e një komisioni të ri për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe shesheve në komunën e Prishtinës.

**Fiknete Bejta** kërkoi që në rend të ditës të futet pika "Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për përcaktimin e kompensimit të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale".

**Egzon Azemi** propozoi që në rend të ditës për diskutim të futet edhe pika "Diskutim për zhvillimet e fundit në Ndërmarrjen Publike Banesore".

**Hafiz Krasniqi** propozoi që në rend të ditës të futet edhe pika "Propozimvendimi për ndihmë financiare biznesve që zhvillojnë veprimtaritë në Tregu me shumicë, të cilët pësuan dëme materiale me rastin e djegëjes së bizneseve të tyre".

**Naim Hoxha** ngriti shqetësim rreth kohës së mbajtjes së mbledhjeve, duke thënë se çfarë kuptimi ka mbajtja e mbledhjes së KPF-së një orë para seancës së Kuvendit, kur duhet ata anëtarë të KPF-së me e informuar këtë grup të asamblistëve se çka është vendosur aty.

Çështja tjetër është se, pothuajse asnjë herë nuk po fillon me kohë seanca e Kuvendit, prandaj kërkohet nga Kryesuesi i Kuvendit që të respektohet koha e fillimit të seancës.

Për shqetësimin e ngritur nga z. Naim Hoxha, kryesuesi dha sqarime të nevojshme.

**Leonora Shabani - Bajraktari**, propozoi që në rend të ditës të futet edhe pika: "Anulimet e konkurseve për drejtorët dhe zëvendësdrejtorët e shkollave", për arsye se është shkelur Udhëzimi administrativ që është nxjerr nga MASHT-i, me numër 1512020, neni 6, ku flitet për komisionin përzgjedhës.

Lidhur me propozimin e znj. Leonora Shabani - Bajraktari sqarime shtesë dhanë Fatos Dibra, zyrtar nga Zyra ligjore, Osman Bllaca dhe Halim Halimi.

**Leutrim Retkoceri** ngriti shqetësim rreth pikave të rendit të ditës, të cilat kanë të bëjnë me këmbimin e pronave, duke thënë se është ofendim ndaj neve që këtu nuk ka drejtorë që na japin informata për pikat e tyre që i kanë për këtë seancë.

Po ashtu, është shqetësuese edhe afati i ankesave të shumë qytetarëve, që kanë aplikuar për dërgimin e fëmijëve të tyre në institucionet parashkollore apo në çerdhe e që nuk janë të pranuar, edhe procedura për të aplikuar dy prindërit për fëmijët e tyre në një çerdhe janë procedura burokratike. Kërkoi nga personat përgjegjës që, për seancën tjetër, të na përgatisin dhe të na tregojnë se cilat janë modalitetet që këtë aplikim ta transformojmë, ta thjeshtëzojmë dhe ta kthejmë në formë elektronike.

Ai propozoi që të futet në rend dite "Propozimvendimi për shkarkimin e aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale "Hortikultura".

**Shefki Gashi** bëri vërejte për pikën e tetë të rendit të ditës "Propozimvendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm, "Prishtina e re - Zona perëndim", i cili tha se për këtë pikë është dashur me pasur një informatë për ta shqyrtuar më herët, me diskutuar për me hy në procedurë të shqyrtimit.

**Agim Gashi** tha se nëse i shtojmë të gjitha pikat e propozuara në rendin e ditës, konsideroj se po dyfishohet rendi i ditës, prandaj ne do t'i votojmë ato pika të cilat janë më të arsyeshme, më me prioritet dhe të diskutohet për to.

**Kryesuesi** i hodhi në votim propozimet e dhëna:

- **Kryesuesi** konstatoi se më 26 vota për dhe 2 kundër, u miratua propozimi "Propozimvendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Prishtina e Re"- Zona perëndimi në Prishtinë", që të hynë në rend të ditës për diskutim.
- **Kryesuesi** konstatoi se më 8 vota për, 21 kundër dhe 1 abstenim, nuk u miratua propozimi "Propozimvendimi për plotësim - ndryshimin e Vendimit për përcaktimin e kompensimit të aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale", që të futet në rend të ditës për diskutim.
- **Kryesuesi** konstatoi se më 7 vota për, 26 kundër dhe 2 abstenime, nuk u miratua propozimi "Diskutim për zhvillimet e fundit në Ndërmarrjen Publike Banesore", që të futet në rend të ditës për diskutim.
- **Kryesuesi** konstatoi se më 5 vota për, 24 kundër dhe 1 abstenim, nuk u miratua propozimi "Propozimvendimi për shkarkimin e Komisionit të aksionarëve të NPL "Hortikultura"", që të futet në rend të ditës për diskutim.

Për propozimin e dhënë nga z. Hafiz Krasniqi, kryesuesi tha se ky propozim mbetet që të diskutohet në mbledhjen e radhës, në mënyrë që ekzekutivi të vijë i përgatitur me shifra konkrete.

Me propozimet e dhëna, më 28 vota për dhe 1 kundër, u miratua ky

#### **Rend i ditës:**

1. **Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;**
2. **Informatë nga Policia e Kosovës;**
3. **Propozimvendimi për plotësim - ndryshimin e Vendimit për miratimin e pakos ekonomike emergjente "Prishtina 2";**
4. **Propozimvendimi për shitjen e automjeteve, si pronë e luajtshme e Komunës;**
5. **Propozimvendimi për plotësim - ndryshimin e Statutit të Qendrës Kulturore të Prishtinës;**
6. **Propozimvendimi për miratimin e Statutit të Galerisë së Qytetit të Prishtinës;**

Faqe3nga8



7. Propozimvendimi për miratimin e Planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara në komunën e Prishtinës, 2021-2023;
8. Propozimvendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Prishtina e Re", zona perëndim" në Prishtinë;
9. Pyetje dhe përgjigje;
10. Të ndryshme.

*Para se të kalohej në pikën e parë të rendit të ditës, Dren Kukaj, drejtor, dha një sqarim para Kuvendit, i cili tha se jemi duke e përgatitur një raport për Ndërmarrjen Publike Banesore, pra duke e përgatitur një plan të gjerë medial, ku do të tregojmë mbi të arriturat e kësaj ndërmarrje dhe këtë raport do ta paraqesim në mbledhjet e radhës së Kuvendit.*

#### **Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.**

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 24 vota për, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së pestë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.**

#### **Pika e dytë**

**Informatë nga Policia e Kosovës.**

Lidhur me Informatën nga Policia e Kosovës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Shkëlzen Xhafa, major.

Rreth çështjes së sigurisë në Komunën e Prishtinës diskutuan: Shefki Gashi, Agim Gashi, Fiknete Bejta, Medina Braha, drejtore, Leonora Shabani - Bajraktari, Vala Peshku, Hafiz Krasniqi, Bashkim Beha, Haki Dragusha, Rifat Deri, Leutrim Retkoceri, Suzan Kika, Adrian Berisha, drejtor, dhe Jeta Rafuna.

Lidhur me shqetësimet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dha Shkëlzen Xhafa, major.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrash Informata nga Policia e Kosovës.**

***Pë shkak të mungesës së kuoromit, kryesuesi konstatoi se mbledhja nuk mund të vazhdojë dhe ajo u ndërpe në orën 14:00.***

*Vazhdimi i mbledhjes së gjashtë, më 21.07.2021, prej orës 10:00.*

**Pika e tretë**

**Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për miratimin e pakos ekonomike emergjente "Prishtina 2".**

**Kryesuesi konstatoi se të pranishëm janë 26 anëtarë të Kuvendit. Më 25 vota për, u miratua Vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për miratimin e pakos ekonomike emergjente "Prishtina 2".**

**Pika e katërt**

**Propozimvendimi për shitjen e automjeteve, si pronë e luajtshme e Komunës.**

**Kryesuesi konstatoi se të pranishëm janë 26 anëtarë të Kuvendit dhe më 23 vota për, u miratua Vendimi për shitjen e automjeteve, si pronë e luajtshme e Komunës.**

**Pika e pestë**

**Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Statutit të Qendrës Kulturore të Prishtinës.**

**Kryesuesi konstatoi se të pranishëm janë 26 anëtarë të Kuvendit dhe më 22 vota për, u miratua Vendimi për plotësim-ndryshimin e Statutit të Qendrës Kulturore të Prishtinës.**

**Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për miratimin e Statutit të Galerisë së Qytetit të Prishtinës.**

**Kryesuesi konstatoi se të pranishëm janë 26 anëtarë të Kuvendit dhe më 24 vota për, u miratua Vendimi për miratimin e Statutit të Galerisë së Qytetit të Prishtinës.**

**Pika e shtatë**

**Propozimvendimi për miratimin e planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Prishtinës, 2021-2023.**

**Suzan Kika** tha se nga shoqata "Hendikos" pyesin se në bazë të cilave kriteret përcaktohet shumica e hollave për ndihmë ose për një zhvillim të një projekti. Po ashtu, përveç se Komuna do ta ndihmojë ndërtimin, a do t'i mbulojë edhe shpenzimet e personelit dhe operative, nëse po, mbi cilin ligj dhe çfarë kriteret duhet të përmbushin edhe shoqatat e tjera për zhvillimin e projekteve të tyre? **Kushtrim Sopa** kërkoi të dijë se a do të hartohen dhe miratohet ndonjë plan sa më shpejt për personat me aftësi të veçanta, për të pasur qasje në të gjitha objektet kulturore, sportive dhe në çdo sferë të jetës, me theks të veçantë në stadiumin "Fadil Vokrri" Prishtinë.

**Shefki Gashi** ngriti shqetësimin rreth mos përfshirjes në marrëdhënie pune të personave me aftësi të kufizuara në institucionet publike. Po ashtu, tha se edhe ndërmarrjet publike private duhet ta kenë parasysh që në mesin e të punësuarve të kenë edhe persona me aftësi të kufizuara.

Lidhur me çështjet e ngritura nga parafolësit rreth qasjes sa më të lehtë të personave me aftësi të kufizuara në institucionet publike, si dhe punësimin e tyre në këto institucione, diskutuan edhe Mehreme Llumnica, anëtare e Komitetit për personat me aftësi të kufizuara dhe Muhedin Nushi, nënkryetar i Komunës.

**Fiknete Bejta** tha se krahas Planit të veprimit për vitin 2021-2023, është mirë që këtij plani të veprimit t'i bashkëngjitet edhe një raport i procesit të avancimit të pikave ose objektivave të Planit të veprimit të vitit 2018-2020, sepse ne do të kishim ditur më shumë sesa kanë arritur të realizohen këto objektiva. Personalisht do ta votojë këtë planë të veprimit, sepse ne duhet të bëjmë diçka për këtë komunitet.

**Mimoza Sylejmani** tha se z. Dren Kukaj ka marrë iniciativë në këtë mandat, që t'i rinovojë të gjitha hapësirat ku do të kenë qasje sa më të lehtë personat me aftësi të kufizuara. Po ashtu, bëj thirrje që në NPL "Pallati i Rinisë" të shihet mundësia e pranimit në marrëdhënie pune edhe të kësaj kategorie shoqërore.

**Vala Peshku** tha se është për të ardhur keq që po debatohet tani për këtë kategori të shoqërisë njerzore, andaj mendoj se ne për katër vite kemi mundur të bëjmë shumë më shumë. Kisha sugjeruar që drejtorive, si ajo e Shëndetësisë dhe ajo e Arsimit, të mos iu votohet asnjë pikë përderisa nuk fillojnë ta aplikojnë Ligjin për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Do të ishte mirë që ato drejtori të cilat nuk kanë asnjë pengës ligjore, ta zbatojnë këtë ligj.

**Agim Gashi** theksoi se do të ishte mirë që të hynte në funksion një porosi nga Kuvendi për institucionet qeverisëse, që ta kenë parasysh atë pjesën që Ligji për shërbyesit civilë është ligj integruar, i integron kategoritë e shoqërisë dhe nuk i dallon. Mendoj se institucionet janë të obliguara ta gjejnë një modalitet, një rrugë, sepse përpos që është ligjore, është edhe humane. Kjo kategori e shoqërisë njerzore nuk po kërkojnë mëshirë, po kërkojnë integrim të barabartë, prandaj logjikisht askush nuk do e kishte penguar procesin e integritit edhe në punësim.

**Drilon Pireva** shprehu mendimin se në rast se një ndërmarrje, Komuna ose kushdo që shpall konkurs vetëm për personat me aftësi të kufizuara, mendoj se është në rregull, për shkak se është ligji specifik që e rregullon këtë çështje. Ai tha se, sipas meje është gjithçka në rregull dhe nuk mundet asnjë person të bëjë ankesë në raport me këtë problem, për shkak se është e rregulluar.

**Hafiz Krasniqi** tha se do të ishte mirë që të jetë një rekomandim i Kuvendit i cili bazohet në kërkesa e asamblistëve, që do të thotë të obligohen ndërmarrjet publike, por njëkohësisht të bëhet edhe një lloj rekomandimi, apo një thirrje qoftë për Komunën, ndërmarrjet publike apo ndërmarrjet private, që ky parim të zbatohet deri në fund për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

**Nazlie Bala** ngrii shqetësimin rreth gjendjes së personave me aftësi të kufizuara, duke thënë se në shoqëri deri më tani, si në nivelin komunal ashtu edhe në nivelin qendror, për këto 20 vjet për këtë kategori shoqërore nuk kemi bërë asgjë, dhe për këtë mendoj se si shoqëri ju kemi borxh shumë, edhe mendoj që duhet të ju kërkojmë falje. Pushteti komunal me politikën e veta mund të krijojë mundësinë, që ju si kategori e kësaj shoqërie njerzore të aplikoni për punësim në konkurset në fushën e mjekësisë apo të arsimit.

**Leutrim Retkoceri** shprehu mendimin se të gjithë ata anëtarë të Kuvendit të cilët janë aksionarë në ndërmarrjet publike lokale, të vijnë me një raport se sa persona me aftësi të kufizuara janë në ato



ndërmarrje të punësuar, dhe bashkë me këtë raport të vijnë edhe me mundësinë për shpalljen e vendeve të lira në ato vende ku mungojnë. Ndërsa drejtoreshës së Drejtorisë së Administratës në Komunën e Prishtinës i kërkohet ta bëjë po të njëjtën gjë dhe të paraqitet me numër të saktë se sa janë të punësuar dhe ku mungojnë këta persona, në cilën drejtori apo në cilat vende mund të krijohen edhe konkurse.

**Sami Boroci** tha se duke pasur parasysh gjendjen financiare të këtyre organizatave, e në veçanti "Hendikosi", kërkoi nga Komuna që në të ardhmen ta shohë mundësinë nëse ka bazë ligjore, që kjo organizatë, në këtë rast "Hendikosi" dhe organizata të ngjashme, me u bë pjesë e Komunës ose me gjetur një formë që Komuna me e nda një pjesë të financimit për nevojat vjetore që këto institucione kanë.

Lidhur me çështjet e ngritura nga parafolësit, sqarime shtesë dha Dren Kukaj, drejtor.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 29 vota për, u miratua Vendimi për miratimin e planit të veprimit për personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Prishtinës, 2021-2023.**

**Pika e tetë**

**Propozimvendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Prishtina e Re" - Zona perëndim, në Prishtinë.**

Lidhur me Propozimvendimin për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Prishtina e Re" - Zona perëndim, në Prishtinë, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Genc Bashota, drejtor.

**Naim Hoxha** tha se për ta miratuar një vendim të tillë, është më se e domosdoshme me qenë prezent të gjitha materialet e nevojshme.

Si mund të merret një vendim kur për atë pikë nuk ka material?!

Pra është absurd që të shtrohet kërkesa për aprovim të këtij propozimvendimi.

**Leutrim Retkoceri** kërkoi të dijë se me këtë revidim të këtij plani, a ka të bëjë me rrugë aktuale të cilat janë dhe për shtëpi individuale, dhe ato rrugë mund të shfrytëzohen edhe nëse parashihet ndërtim i lartë, apo do të bëhet riparilizimi vetëm për rrugë e pastaj duhet të ndryshohet edhe një herë, apo është ndryshimi përfundimtar që bëhet për atë zonë.

Lidhur me çështjen e ngritur nga z. Leutrim Retkoceri, sqarime shtesë dha Genc Bashota, drejtor.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 24 vota për, u miratua Vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Prishtina e Re" - Zona perëndim, në Prishtinë.**

**Pika e nëntë**

**Pyetje dhe përgjigje**

**Kushtrim Sopa, për drejtorin e Drejtorisë së Kulturës dhe drejtorin e Drejtorisë së Sportit:**

- A do të hartohet dhe miratohet ndonjë plan sa më parë që është e mundur për çasjen për personat me aftësi të veçanta në të gjitha objektet kulturore, sportive dhe çdo sferë të jetës, me theks të veçantë në stadiumin "Fadil Vokrri", në Prishtinë?
- Si janë zhvilluar dhe ku kanë ngecur procedurat në lidhje me objektin e Xhamisë qendrore të Prishtinës?

**Për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:**

- Përgjatë rrugës "Tirana", ose siç thonë qytetarët, qoshit nga Trock Taverna e deri tek rrethrotullimi i lagjes "Arbëria" ose stadiumit "Fadil Vokrri", ka mbetur një gropë e madhe, e cila po shfrytëzohet fatkeqësisht për hedhje të mbeturinave, ku janë krijuar kënetat, dhe me gjasë mundet me pasur edhe gjarpërinjë në atë vend. A kishte me qenë e rrugës që ajo gropë të mbyllet sa më parë, ngase është pronë publike, dhe të bëhet një minipark të cilin do ta shfrytëzonin fëmijët dhe banorët e lagjes.

**Për drejtoren e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:**

- Shqetësim i banorëve të lagjes "Arbëria" prapë për qentë e shumtë në lagjen tonë, rruga "Stambolli" në lagjen "Arbëria". Imagjinojeni, 500 metra nga shkolla fillore "Mehmet Xheveri", fëmijët i dërgojnë me kombi në shkollë me pagesë! Për qenët endacak pa pronar ka pasur reagime edhe nga Ambasada amerikane në raportimet e fundit, po dikush është duke fjetur! Qytetarët e lagjes "Kolovica" kanë një shqetësim shumë të madh, për të cilin kërkojnë intervenim nga Komuna me polici në rrugën "Haxhi Zeka", rruga për Kolovicë, me ua liruar trotuaret prej makinave të parkuara, pasi që 90% të rrugës duhet me ecur nëpër rrugë se veturat po parkohen në trotuare. Fëmijët çdo ditë shkojnë në shkollë dhe janë të rrezikuar prej këtyre njerëzve të pandërgjegjshëm.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

**Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi**



**Faqe 8 nga 8**